



Albanian Neurosurgical Society – ANS

Albanian Neurosurgical Society (ANS)

Shoqata Shqiptare e Neurokirurgjise (ShShN)

STATUTI

(projekt-statut: për tu plotësuar në rast vërejtjesh)

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Shoqata mban emrin Shoqata Shqiptare e Neurokirurgjisë, me akronim ShShN dhe emërtim ndërkombëtar Albanian Neurosurgical Society, akronimi ANS.
2. Kjo shoqatë perfaqëson një bashkim të individëve (dhe/ose shoqërive) të interesuar për shkëmbim, zhvillim dhe edukim në fushën e neurokirurgjisë.
3. Qellimi i saj është të promovojë aplikimin e neurokirurgjise sipas standarteve bashkekohore në Shqipëri dhe në komunitetin shqipfolës duke lidhur dhe edukuar në vazhdim neurokirurget dhe specialistet e fushave ndervepruese me ta, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, falë angazhimit në EANS dhe ËFNS.
4. Shoqata ka interes të mirefillte publik mjekësor, shkencor dhe akademik dhe është jofitimpruese.

Neni 2

Vula dhe Simboli

1. Shoqata ka vulën e saj, e cila përmban emrin e saj.
2. Shoqata ka gjithashtu një logo, e cila përdoret në të gjitha dokumentet e shoqatës dhe mjetet e saj të komunikimit.



Neni 3

Selia

Shoqata e ka qendrën e saj në Tiranë. Bordi përcakton selinë e shoqatës.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqata do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar. Ajo shpërndalet me vendim të Bordit Drejtues dhe të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 5

Qëllimi dhe Objektivat e Veprimtarisë

Shoqata është një shoqatë (bashkim) jo fitimrurëse e individëve (dhe shoqatave te tjera) dhe përfaqëson një njësi gjeografike, kulturore dhe profesionale

Objektivat e saj janë:

1. Rritja dhe nxitja e shkëmbimit të njohurive neurokirurgjikale dhe përvijës midis anëtarëve
2. Promovimi i interesave të neurokirurgjisë si specialitet dhe disiplinë , si dhe promovimi i interesave të neurokirurgëve dhe të pacientëve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. të lehtësojë dhe të ndihmojë në trajnimin e vazhdueshëm të neurokirurgëve dhe profesioneve të lidhura me këtë disiplinë si dhe të specializantëve të neurokirurgjisë dhe studentëve aspirantë neurokirurgë.
4. të ndërtojë dhe të mirëmbajë raportet me shoqatat e tjera neurokirurgjikale kombëtare e ndërkombëtare.

Për të realizuar objektivat e saj shoqata organizon vec të tjerash aktivitetet vijuese:

1. Takimin e Neurokirurgjeve Shqiptare me një shpeshësi të paktën çdo dy-tre vjet.
2. Takime bilaterale dhe multilaterale me shoqata të tjera kombëtare e ndërkombëtare
3. Organizimin e aktiviteteve trajnuese në fushën e edukimit të lidhura me zhvillimin e Neurokirurgjisë
3. Këshillimin e anëtarëve mbi trajnimet në neurokirurgji për të ruajtur standartet e unifikuara kombëtare e ndërkombëtare
4. Këshillim në çështjet kryesore të parashtruara nga anëtarët.



Albanian Neurosurgical Society – ANS

Shoqata është anëtare në Shoqatën Europiane të Neurokirurgjisë (EANS) si dhe në Federatën Botërore të Shoqatave të Neurokirurgjisë (ËFNS), dhe vepron sipas modelit të ngjashëm të këtyre organizatave, të pershtatur për kushtet e kapaciteteve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqata mund të japë certifikata për specialistë të fushës mjekësore ose sociale me kontribute të rëndësishme në sistemin shëndetësor vendas ose të huaj.

Organizata do të komunikojë me opinionin publik nëpërmjet të gjitha mjeteve të komunikacionit masiv, si dhe botimeve të saj.

KREU II

TË ARDHURAT / KAPITALI

Neni 6

Burimet e financimit të shoqatës janë të përbëra nga fonde të siguruara nga vetë Shoqata, kuotizacionet e anëtarëve, donacionet e ndryshme si private edhe shtetërore, subvencionet dhe çdo burim tjetër që nuk është i ndaluar nga ligji.

Neni 7

Administrimi i të ardhurave

Të ardhurat e kuotizacioneve përdoren për nevoja të shoqatës dhe pagesat e detyrimeve ndaj EANS dhe WFNS.

Kuotizacioni është 2500 lekë per anëtarë.

15 EU per EANS

8 \$ per WFNS

Të ardhurat e realizuara nga aktiviteti dhe burimet e financimit qëndrojnë në fondin e shoqatës për tu përdorur në vazhdim nga aktiviteti i saj. Është e ndaluar cfarëdolloj shpërndarje e fitimeve ndërmjet anëtarëve apo të tretëve.

Kuota e anetaresise mund te revizionohet cdo vit (n argumentim te vitit financiar dhe parashikimit te vitit te ardhshëm) me propozim te treasurer dhe vendim të bordit drejtues, të miratuar nga presidenti.



KREU III

ANËTARËSIMI

Neni 8

Anëtarët

1. Anëtar i ASN/ShShN mund të jetë çdo neurokirurg apo specialist i një prej fushave të lidhura direkt me të (psh. *neurologet, neuroradiologet, neuroanestezistet, neuroonkologet, neuroendokrinologet, neurofiziologet, neuropatologet, neurooftalmologet, neurootojatr, neuropsikologet e psikiatrit e interesuar ne sindromat specifike te pacienteve neurokirurgjikale, fizioterpiste, infermiere, biologe, gjenetistë, fizikante ,neuoshkencetare etj.*) si dhe studente te ketyre fushave qe i pershtaten dhe respektojne statutin e shoqates dhe si rrjedhim pranohet nga Bordi Drejtues dhe/ose Asambleja dhe ka paguar kuotën e anëtarësisë.
2. Paguesa e kuotës së anëtarësisë është kusht thelbesor për të qenë anëtar i shoqatës. Nëse anëtarët nuk paguajnë kuotën, ata nuk mund të konsiderohen anëtarë dhe nuk kanë asnjë të drejtë lidhur me organizatën.
3. Anëtarët mund të jenë individë që plotësojnë kriteret e pikës 1 (shqiptarë ose të huaj) dhe që ushtrojnë veprimtarinë klinike dhe/ose shkencore në territorin e Republikës së Shqipërisë, Shqiptarë të trojeve dhe Shqiptarë te Diasporës.
4. Shoqata mund të ketë Shoqeri “affiliated” te cilat mund te jene shoqëri jashte kufijve shtetërore shqiptare ose shoqëri të specialiteteve me interes në neurokirurgji.
5. Shoqatat “affiliated “ do te informohen për veprimtarinë e shoqatës nëpërmjet website dhe emailit të anëtarëve dhe do të ftohen të bashkëpunojnë në to.

Neni 9

Të Drejtat e Anëtarëve

1. Çdo anëtar i ANS, i cili rezulton në regjistrin e anëtarësisë pasi ka paguar kuotizacionin përkatës, bëhet automatikisht anëtar i Asamblesë së Përgjithshme të ANS.
2. Çdo anëtar i lind e drejta të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese apo në komisione të ndryshme të krijuara në kuadër të shoqatës.
3. Çdo anëtar gëzon të drejtën e një vote në votimet që zhvillohen për zgjedhjet e organeve drejtuese apo për çështje të tjera. Në rregulloren e shoqatës do të përcaktohen rregullat e hollësishme për mënyrën e votimit dhe të përlllogaritjes së votave.



Albanian Neurosurgical Society – ANS

4. Anëtarët kanë detyrimin të respektojnë vendimet dhe detyrimet e tyre të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme dhe duhet të ndjekin veprimtari që janë në përputhje me interesat e Shoqatës dhe nuk e dëmtojnë atë.
5. Anëtarët mund të përjashtohen nga Asambleja e Përgjithshme me vendim të saj, sipas procedurave të parashikuara në këtë Statut, në Aktin e Themelimit, si dhe rregulloret e brendshme të Shoqatës, kur:
 - a) abuzojnë me fondet e dhëna nga Shoqata;
 - b) tejkalojnë kompetencat e dhëna nga ky Statut;
 - c) marrin pjesë në veprimtari të paligjshme;
 - d) nuk paguajnë detyrimet;
 - e) i kanë sjellë dëme Shoqatës me veprimtarinë e tyre;
 - f) si dhe për raste të tjera të gjykuara të arsyeshme nga Asambleja.

KREU IV

PËRBËRJA, FUNKSIONET E ORGANEVE DREJTUESE

Neni 10

Organet Drejtuese të ANS

Drejtuesit e ANS janë:

- Presidenti
- Sekretari
- Trezorieri

Organet kryesore të shoqatës janë:

- Bordi Drejtues
- Asambleja e përgjithshme

Presidenti i parë i shoqatës është Mentor Petrela MD, PhD, Chev LH, PU-PH Fr, WANS, IFAANS



Neni 11

Asambleja e Përgjithshme – Formimi – Thirrja – Vlefshmëria – Caktimi i Votave – Funksionimi

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i **ANS**.
Vendimet e saj janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët.
2. Asambleja përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqatës, të regjistruar në regjistrin e anëtarësisë.
Asambleja e zakonshme mbledhet jo më pak se cdo dy vjet dhe thirret nga Presidenti ose sekretari me autorizim të presidentit si dhe nga bordi i drejtuesve kur gjykohet e arsyeshme
3. Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë vendin ku do të zhvillohet mbledhja, datën, orën si dhe rendin e ditës.
4. Asambleja drejtohet nga Presidenti dhe në mungesë të tij nga Sekretari.
5. Presidenti, para fillimit të mbledhjes cakton një protokollues dhe dy numërues votash kur ka vendime që do të votohen.

Neni 12

Atributet e Asamblesë Asambleja në mbledhjet e saj të zakonshme

1. Asambleja zgjedh nga radhët e saj Bordin Drejtues;
2. Përcakton rregullat për pranimin e anëtarëve të rinj në **ANS**
3. Merr vendime dhe aprovon propozime në lidhje me strategjitë dhe çështje të tjera kardinale.
4. Merr vendime që kanë të bëjnë me financimin e organizatës;
5. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
6. Asambleja në mbledhjet e saj të jashtëzakonshme vendos për ndryshimet në Statut me votën “pro” të shumicës të të pranishmëve.

Neni 13

BORDI DREJTUES

Veprimtaria e ANS mbikëqyret nga Bordi Drejtues.



Neni 14

Kompetencat e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues mbikëqyr drejtimin dhe administrimin e ANS. Ky bord ka këto kompetenca:

1. Ndjek zbatimin e vendimeve të Asamblesë, duke përcaktuar veprimtarinë afatshkurtër të Organizatës. Harton plane për veprimtarinë afatmesme dhe afatgjatë.
2. Përcakton masën e kontributit (kuotës) të anëtarësisë.
3. I paraqet Asamblesë raportin vjetor të veprimtarisë së Shoqatës dhe raportin financiar, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhë.
4. Përgatit projektin për ndryshimet e Statutit për t`ia paraqitur për miratim Asamblesë së Përgjithshme.
5. Mblidhet me kërkesën e Presidentit, ose me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të Asamblesë sipas nevojës.
6. Mbledhja e Bordit Drejtues konsiderohet e rregullt, nëse në të marrin pjesë jo më pak se gjysma, plus një, e anëtarëve të tij.
7. Vendimet quhen të vlefshme kur merren nga të paktën gjysma e anëtarëve të pranishëm. Në rast barazie votash, vendos vota e Presidentit. Nuk është i mundur votimi nëpërmjet prokurës.
8. Vendimet e Bordit Drejtues regjistrohen në proces-verbalin e mbledhjes të firmosur nga Presidenti dhe Sekretari.
9. Njoftimi për mbledhjen e Bordit Drejtues bëhet me shkrim jo më vonë se 7 ditë nga data e mbledhjes përkatëse.

Neni 15

Përbërja

Bordi Drejtues përbëhet nga 3 (tre) drejtuesit që zgjidhen nga radhët e anëtarësisë.

Neni 16

Emërimi i anëtarëve të Bordit Drejtues dhe Kohëzgjatja

1. Anëtarët e Bordit Drejtues zgjidhen një herë në katër vjet. Mandati ka të drejtë rinovimi.
2. Themeluesit e shoqatës mbeten “honoured”.



Neni 17
Presidenti

1. Përfaqëson ligjërisht ANS
2. I rekomandon Asamblesë së Përgjithshme iniciativa të ndryshme në lidhje me veprimtarinë e zhvilluar nga ANS për realizimin e qëllimit të saj.
3. Drejton mbledhjet e bordit drejtues dhe Miraton çështjet e rendit të ditës të propozuara nga Bordi Drejtues.
4. Në përmbushjen e funksioneve të tij mbikëqyr aktivitetin e ANS dhe administrimin normal të saj.
5. Presidenti kujdeset për zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, të Bordit Drejtues dhe të dispozitave të këtij Statuti dhe rregulloreve përkatëse.
6. Presidenti drejton Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 18
Funksionimi i Shoqatës

1. ANS funksionon në bazë të këtij Statuti, Aktit të Themelimit, legjislacionit në fuqi dhe të rregulloreve përkatëse që përgatiten mbi bazën e tij.
2. Veprimtaria e përditshme e saj udhëhiqet nga Presidenti, i cili përfaqëson ANS në lidhje me të tretët në perputhje me nevojat e realizimit të projekteve dhe mundësite financiare, merr në punë me kohë të plote ose të pjesshme studiues e punonjës të tjerë ndihmes, sipas procedurave të miratuara nga Bordi Drejtues

KREU V

FINANCAT

Neni 19
Roli i Trezorierit

1. Detyrat e mbajtësit të thesarit janë:
 - a. Të prezantojë buxhetin në Bordin Drejtues dhe në Asamblenë e Përgjithshme;
 - b. Të propozojë dhe të argumentojë tarifën për kuotën e anëtarësisë;
 - c. Të raportojë vazhdimisht në Bordin Drejtues dhe para Presidentit për të ardhurat dhe shpenzimet, dhe një herë në vit të raportojë në Asamblenë e Përgjithshme;
 - d. Të këshillojë Bordin Drejtues lidhur me investimet.



2. Bordi Drejtues mund të caktojë një auditues të jashtëm dhe të pavarur (Ekspert Kontabël) i cili përgatit një raport për Asamblenë e Përgjithshme mbi llogarinë vjetore.
3. Mbajtësi i thesarit mund të ketë në dispozicion të tij shërbimet e një llogaritari, i cili duhet të jetë pjesë e personelit/stafit.

Neni 20

Mbajtja dhe Miratimi i Bilancit

Librat financiar të Shoqatës mbyllen në fund të çdo viti financiar. Në bazë të tyre Thesarmbajtësi i emëruar nga Presidenti përpilon bilancin financiar dhe atë vjetor të të ardhurave dhe të shpenzimeve për vitin pasardhës financiar. Brenda gjashtë muajve para përfundimit të vitit financiar, bilanci kontabël dhe ai vjetor i të ardhurave dhe shpenzimeve duhet ti paraqitet Bordit Drejtues.

Në rastet kur janë plotësuar kushtet për marrjen e një eksperti kontabël të jashtëm, bilanci shoqërohet edhe me raportin e ekspertit kontabël të jashtëm.

Neni 21

Shpërndarja dhe Likuidimi

1. Bordi Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme shpërndajnë Shoqatën me anë të një vendimi të marrë në mënyrë të arsyetuar.
2. Shpërndarja e Shoqatës shpallet në Mbledhjen e Bordit Drejtues dhe më pas të Asamblesë, në këto raste:
 - a. Veprimtaria rezulton në kundërshtim me qëllimin e krijimit të Shoqatës;
 - b. Kur Shoqata realizon qëllimin për të cilin është krijuar;
 - c. Kur vërtetohet se shoqata ka filluar të ushtrojë veprimtari të paligjshme
 - d. Në raste të tjera të parashikuara në ligj.



Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij Statuti, organet drejtuese do të përpiqen ta zgjidhin me mirëkuptim ndërmjet tyre.
2. Nëse mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, për zgjidhjen e tyre është kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 23

Dispozita të fundit

Për gjithçka që nuk është parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Ky statut hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje origjinale.

Statuti nënshkruhet nga themeluesit e Shoqatës.

Anëtarët Themelues të Shoqatës: